

KONTRATE SHITJE



Sot ne Tirane me date 16.09.2004, ndermjet paleve;

- SHITES:** Shoqeria "ALBANIAN EAGLE" Sh.p.k, person juridik shqiptar i regjistruar me vendimin e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, nr. 12958, date 01.12.1995, e perfaqesuar nga Administratori i Shoqerise Ilir Pilhati, mbajtes i pasaportes nr. 1440913.
- BLERES:** Stefano MATTEI, shtetas Italian, lindur me 04.10.1960, mbajtes i pasaportes nr. 6004612V, banues ne Itali ne adresen: Vaiano (PO) Via Meretto nr.2, i cili perfaqesohet ne kete kontrate, nga Ylli Sula, lindur me 01.08.1966, banues ne Tirane Rruga Mihal Grameno nr 210/1, me pasaporte nr. 0067992, ne baze te te drejtave qe i jane dhene me Prokuren e Posaçme date 15.09 2004, nr. 5683 repertori.

MEQENESE

1. Shitesi Shoqeria "ALBANIAN EAGLE" Sh.p.k, me Vendimin e Asamblese date 16.09.2004, ka vendosur te shese 10 pjeset qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise "ÇELESI" Sh.p.k., e regjistruar me vendimin e Gjykates se Tiranes nr. 18233, date 04.12.1997.
- 1.1 Ortaku Stefano MATTEI, ka rene dakord te bleje nga Shitesi, Shoqeria "ALBANIAN EAGLE" Sh.p.k, 5(pese) pjeset qe kjo zoteron ne kapitalin e Shoqerise "ÇELESI" Sh.p.k.
- 1.2 Shitesi garanton Bleresin se ne daten e sotme, pronesi e tij mbi pjeset eshte e lire nga çdo barre, peng dhe çdo lloj detyrimi tjetër ligjor.


PALET BIEN DAKORT PERSA ME POSHTE VIJON

2. Shitesi Shoqeria "ALBANIAN EAGLE" Sh.p.k, i shet Bleresit, Stefano MATTEI, 5(pese) pjeset, qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise "ÇELESI" Sh.p.k, perkundrejt çmimit 12.500EURO(dymbledhjetmijepeseqind).
- 2.1 Bleresi Stefano MATTEI, i pagoi Shitesit Shoqeria "ALBANIAN EAGLE" Sh.p.k, te gjithë vleren e çmimit te shitjes prej 12.500EURO(dymbledhjetmijepeseqind).

3. Ne momentin e nenshkrimt te kesaj kontrate Bleresi Stefano MATTEI, fiton pronesine mbi 5 pjeset zoteronte Shitesi, shoqeria "ALBANIAN EAGLE"Sh.p.k, ne kapitalin e Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, te cilat perbejne 5% te kapitalit te kesaj te fundit, duke rritur pjesemarrjen (zoterimin) e tij ne kapitalin e Shoqerise "ÇELESI"Sh.p.k, nga 10 pjese ne 15 pjese, qe perbejne 15% te kapitalit te saj. Ndersa Shitesi "ALBANIAN EAGLE"Sh.p.k, nga ky moment, humb ne menyre te plote dhe definitive pronesine mbi 5 pjeset qe shet dhe mbi çdo te drejte tjeter qe i rridhte prej tyre. Transferimi i pronesise se 5 pjeseve tek Bleresi nuk e ngarkon kete te fundit me asnje detyrim qe Shitesi mund te kete krijuar ne menyre individuale ndaj te treteve deri ne daten e sotme.

3. Shitesi dhe Bleresi autorizojne qe kjo kontrate te depozitohet ne Zyren e Regjistrat Tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kjo kontrate hartohet ne 4 kopje me vlere te njejte, ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet nga Shitesi dhe Bleresi.



PALET

SHITES

Shoqeria "ALBANIAN EAGLE"Sh.p.k

Perfaqesuar nga:

Administratori

ILIR PILKATI

BLERES

Stefano MATTEI